



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1076/4 prot.

Datë 29.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 565/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. REF-80711-04-01-2026, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Valias, Grupi 1” me fond limit 172,262,930.82 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 17.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” Shpk me NIPT J91915001P dhe me adresë Lagjia Zall - Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054, Kamëz.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz me adresë Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.04.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me nr. Nr. REF-80711-04-01-2026, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Valias, Grupi 1” me fond limit 172,262,930.82 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 17.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 08.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6499 dhe nr. 1076/2026 prot., datë 08.04.2026, e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën me nr. 3868/1 prot., datë 15.04.2026, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1076/1 prot., datë 17.04.2026, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e



Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.1.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
  - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
  - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
  - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.5. Në nenin 84 pika 1,3 dhe 6 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet

*në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

*3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

*6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.”*

III.1.6. Në nenin 41 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “2. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.7. Në nenin 90 pika 1 dhe 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. *Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

*6.Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.”*

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlereson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në rastin konkret duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit i cili kërkon që të hiqet kufizimi i vënë nga autoriteti kontraktor që nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme si dhe për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve objekt i kontratës), stafi inxhinierik (drejtuesit teknik) 2.3.4, nga shqyrtimi dokumenteve të tenderit rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar aspektet në të cilat nuk lejohet mbështetja dhe që kanë të bëjnë me kufizimet e përmendura më sipër. KPP gjykon, se ligjvënësi përmes *lex specialis* por edhe rregullave të prokurimit publik që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit kanë përcaktuar mundësinë e operatorëve ekonomikë ofertues për t'u mbështetur në kapacitetet teknike, profesionale dhe ekonomike të subjekteve të tjera ashtu sikurse kanë lënë në diskrecionin e autoriteti kontraktor që të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës ofruesi të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, por të përmbushen nga vetë ai me kushtin që ky informacion të publikohet në dokumentet e tenderit. Fakti që ligji dhe rregullat e prokurimit publik i kanë dhënë diskrecionin autoritetit kontraktor që të vendosë kufizime mbi aspekte të caktuara të mbështetjes në subjektet e tjera nuk do të thotë që ato të bëhen pa një argumentim të saktë dhe të detajuar që justifikon kufizime të tilla. Sa i përket argumentit të Autoritetit Kontraktor mbi rëndësinë e veçantë të kontratës dhe vlerën e lartë të investimit, Komisioni vlerëson se këto elemente nuk justifikojnë ndalimin e vendosur nga autoriteti kontraktor për mbështetjen në kapacitete të subjekteve të tjera. Vetë ligjvënësi përmes ligjit për prokurimin publik por edhe në rregullat e prokurimit publik ka kufizuar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për aspekte kritike ku autoriteti kontraktor në rastin konkret ka dështuar të argumentojë në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim pse elementët më sipër përbëjnë aspekte kritike në raport me aspekte të tjera për të cilat ka lejuar mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se kufizimi i vendosur nga Autoriteti Kontraktor për moslejimin e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera është joproporcional, diskriminues dhe në kundërshtim me frymën dhe dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik. Përsa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë Seksionin 2: “Objekti i Kontratës”, pika 2.16 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke hequr ndalësën për mbështetjen në kapacitetet teknike të subjekteve të tjera për të gjithë elementët e përmendur në këtë pikë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruktion” SHPK, për modifikimin e kriterit 2.3.1 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar... *kerkesa per prokurën e posacme të deklaruara në fazën e tenderimit eshte e gabuar dhe duhet te hiqet..*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.1., ka parashikuar si më poshtë:

### **2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 86,131,465.4 (tetëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë katër) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 344,525,862 (treqind e dyzet e katër milion e pesëqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për te vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

- Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:

a) Kontratën e Sipërmarrjes,

b) Situacionin përfundimtar të objektit

c) Aktin e Kolaudimit të objektit

d) Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer)

e) Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar të punimeve.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:

a) Kontratën e Sipërmarrjes,

b) Situacionin përfundimtar të objektit

c) Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore

d) Aktin e Kolaudimit të objektit

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

- *Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;*
- *Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

*Kontratë bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.*

III.2.2. Neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*

*4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.2.3. Në nenin 88 pika 1,2 dhe 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

*2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi*

*duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*

- 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

III.2.4. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.2.5. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues lidhur me kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, KPP gjykon, se kriteri në fjalë për sa i përket prokurës së posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit, nuk është në përputhje me asnjë nga përcaktimet e *lex specialis*, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pra autoriteti kontraktor nuk i është përmbajtur parashikimeve ligjore të *lex specialis*, në lidhje me hartimin e këtij kriteri kualifikimi. Ligji për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore përkatëse parashikojnë qartë që, anëtarët e një bashkimi operatorësh ekonomikë caktojnë përfaqësuesin e tyre përmes kontratës së bashkëpunimit. Kjo kontratë, e nënshkruar

nga të gjithë anëtarët, ka fuqi ligjore autorizuese pa qenë e nevojshme një prokurë e veçantë. Në rastin konkret, KPP vlerëson se, kërkesa për prokurë të posaçme nuk është një kërkesë ligjore, përkundrazi ajo është një shtesë e panevojshme dhe si e tillë mund të kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar. Qëllimi i nenit 88 të VKM është të sigurojë që bashkimi të ketë një përfaqësues të qartë dhe të autorizuar, qëllim i cili arrihet përmes kontratës së bashkëpunimit, e cila vërteton përfaqësimin në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, pa pasur nevojë për dokument shtesë, sikurse është prokura e posaçme e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Sa më sipër, Komisioni gjykon se kërkesa për prokurë të posaçme në rast bashkimi operatorësh ekonomikë është e pajustificuar, e për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij përcaktimi nga kriteri i kualifikimit 2.3.1.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruktion” SHPK, për modifikimin e kriterit 2.3.4. të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar:.. *Kërkesa që operatori ekonomik të ketë në licencë një Drejtues Teknik Inxhinier Hidrogeolog dhe një Drejtues Teknik Inxhinier Ndërtimi, Profili Gjeoteknik nuk justifikohet për objektin e prokuruar, i cili përfshin vetëm punime rrugore urbane (shtresa rrugore, trotuare, kanalizime të thjeshta, mbushje dhe nivelim).Nuk ka punime gjeoteknike komplekse, themele të thella, mure mbajtëse të larta apo punime nënujore, punime hidrogeologjike të thella, diga, tunele ose stabilizim shpatësh. Për këtë arsye, kërkesa për Inxhinier Hidrogeolog dhe Inxhinier Ndërtimi Profili Gjeoteknik duhet të hiqet nga lista e profileve që operatori ekonomik duhet të disponojë në licencë..”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5.., ka parashikuar si më poshtë:

#### **2.3.4 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për këto punime:**

*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik te shoqërisë, inxhinierët e mëposhtëm:*

- *Inxhinier Ndërtimi* 1 (një)
- *Inxhinier Hidroteknik* 1 (një)
- *Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder* 1 (një)
- *Inxhinier Hidrogeolog* 1 (një)
- *Inxhinier Ndërtimi, Profili Gjeoteknik* 1 (një)

*Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin sipas kërkesave të mëposhtme:*

- *Stafi teknik i sipërcituar duhet të figurojë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.3.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.3.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.5. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.3.6. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriterë autoriteti kontraktor ka argumentuar: **Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve

rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

**1 Inxhinier Ndërtimi:** Referuar preventivi të punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-1, N.P-4**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të infrastrukturës rrugore, përfshirë shtresat rrugore, trotualet dhe elementët përbërës, duke garantuar zbatimin korrekt të projektit dhe cilësinë e punimeve.

**1 Inxhinier Hidroteknik:** Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **N.P-7**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**. Kërkohet për projektimin/zbatimin dhe kontrollin e sistemit të ujërave të kanalizimeve, të domosdoshme për ruajtjen e qëndrueshmërisë së trupit të rrugës dhe shmangien e dëmtimeve.

**1 Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder:** Referuar preventivi të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **N.P-4, N.S-6, NS 18**. Kërkesa për 1 Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder është e domosdoshme pasi ai siguron zbatimin e saktë të projektit në terren, duke përcaktuar koordinatat, kuotat, piketimet dhe gjurmën e rrugës. Ai kontrollon nivelimet dhe parametrat teknikë gjatë gjithë fazave të punimeve, si dhe realizon matjet për volume dhe situacione. Prania e tij garanton cilësi, shmang devijimet nga projekti dhe është thelbësore për realizimin korrekt dhe sipas standardeve të punimeve rrugore.

**Inxhinier Hidrogjeolog:** Analizon ndikimin e ujërave nëntokësore mbi strukturën e rrugës, duke ndihmuar në parandalimin e dëmtimeve që mund të vijnë nga infiltrimi apo lagështia e vazhdueshme.

Prezenca e tij është e domosdoshme pasi në terrenin ku do të ndërtohet është në afërsi të **Lumit Tiranës** dhe ka prezencë uji si zona më e ulët ujëmbledhëse, i cili do të krijojë destabilitet në ndërtimin e rrugës si dhe çarjen e strukturës së saj. Pra duke qenë se kjo zonë është problematike për ujjat nëntokësore dhe shpesh herë kemi hasur prishje të strukturave të rrugëve që janë ndërtuar, inxhinieri do të gjejë zgjidhje për largimin e ujit si dhe rrugët e kalimit të tij për mos t'u krijuar probleme të mëvonshme në strukturën e rrugës.

**Inxhinieri i Ndërtimit profili gjeoteknik:** studion vetitë mekanike të tokës dhe përcakton zgjidhjet më të përshtatshme për themelimin dhe shtresat rrugore, në mënyrë që të shmangen deformimet, uljet apo çarjet gjatë shfrytëzimit të rrugës.

Ky inxhinier është përgjegjës për zbatimin e testeve gjeoteknike dhe për të përcaktuar përshtatshmërinë e vendit për ndërtim. Testet ofrojnë të dhëna të çmuara mbi vetitë fizike dhe mekanike të dheut, duke përfshirë llojin, fortësinë, densitetin, përshkueshmërinë, porozitetin dhe kompaktimin, ndër të tjera. Kuptimi i këtyre karakteristikave ndihmon inxhinierët të parashikojnë sjelljen e dheut nën kushte të ndryshme ambientale dhe ngarkesa, dhe i

*mundëson ata të projektojnë themelin e strukturës në mënyrë efektive dhe të sigurt. Ai udhëzon zgjedhjen e metodës së duhur të ndërtimit dhe materialeve që do të përdoren. Së fundi, ai ndihmon në kursimin e kostove duke zvogëluar rrezikun e dështimit struktural që mund të çojë në veprime korrektive të kushtueshme.*

*studion vetitë mekanike të tokës dhe përcakton zgjidhjet më të përshtatshme për themelimin dhe shtresat rrugore, në mënyrë që të shmangen deformimet, uljet apo çarjet gjatë shfrytëzimit të rrugës.*

*Parë kjo në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuara, vlerën dhe natyrën e punimeve, kërkesat e mësipërme janë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë.*

III.3.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij *1 (një) inxhinier ndërtim, profili Gjeoteknik*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesa e autoritetit kontraktor *1 (një) inxhinier ndërtim, profili Gjeoteknik*, nuk i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni sqaron se, *Inxhinieria Gjeoteknike është një degë e inxhinierisë civile që merret me studimin e provave mekanike dhe fizike të tokës dhe materialeve të tjera gjeologjike, si dhe përdorimin e këtyre informacionit për të projektuar dhe ndërtuar struktura të sigurta dhe të qëndrueshme. Inxhinierët gjeoteknikë janë përgjegjës për analizimin e kushteve të tokës dhe të ndërtimit në të, për të siguruar që ndërtimet të jenë të qëndrueshme dhe të mos shkaktojnë dëme mjedisore ose strukturore.* Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij, duke e lidhur nevojën për stafin e përmendur më sipër edhe me faktin se autoriteti kontraktor ka kërkuar në dokumentet e tenderit licenca të punimeve: *NP-1/A-Punime gërmimi në tokë, NP-4/D -Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, NS-6/B-Sinjalistika rrugore jondriçuese, NS-18/A Punime*

*topogjeodezike*, ku kategoria e kryerjes së punimeve sipas licencave më sipër, shfaq nevojën që operatorët ekonomikë të kenë në stafin e tyre inxhinierë të profileve si inxhinier ndërtimi profili infrastrukture transporti, inxhinier topograf/gjeodet/markshajde. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në procesverbalin e argumentimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike, nuk ka arritur të argumetojë nevojën për staf të profilit të tillë (si gjeoteknik). Në këtë mënyrë, KPP gjykon, se kërkesa për *I (një) inxhinier ndërtim, profili Gjeoteknik*, nuk është proporcionale me objektin e prokurimit dhe nuk i shërbejnë autoritetit kontraktor për realizimin e qëllimit dhe përmbushjen me sukses të kontratës. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në kushtet kur synimi i autoritetit kontraktor, për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, sa i përket personelit të nevojshëm, realizohet nëpërmjet plotësimit të kërkesës për disponimin e inxhinierit të ndërtimit profili infrastrukture transporti, inxhinier topograf/gjeodet/markshajde, në këtë rast kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e *I (një) inxhinier ndërtim, profili Gjeoteknik*, nuk është më, i nevojshëm për autoritetin kontraktor në funksion të realizimit të qëllimit të tij, sikurse është realizimi me sukses i kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kësaj kërkesë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes të paraqitura në ankesë, sa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor ku si pjesë e stafit të kualifikuar të jetë edhe *inxhinieri hidrogjeolog*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Në rastin konkret kemi të bëjmë me punime në rrugë në një zonë të banuar ku roli i inxhinierit hidrogjeolog bëhet edhe më i rëndësishëm, për shkak të rreziqeve dhe kërkesave të shtuara që lidhen me sigurinë e banorëve dhe stabilitetin e zonës. Inxhinieri hidrogjeolog luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e rrugëve, sidomos kur bëhet fjalë për menaxhimin e ujërave nëntokësore dhe vlerësimin e kushteve hidrogjeologjike të terrenit. Ky lloj inxhinieri merret me studimin e ujërave nëntokësore dhe ndikimin e tyre në strukturën dhe qëndrueshmërinë e projektit të ndërtimit të rrugës. Në këto raste, vlerësimi i kushteve gjeologjike dhe infrastrukturës është më kompleks dhe kërkon më shumë kujdes. Kur kryhen punime rruge në një zonë të banuar, mund të ketë ndikime të ndryshme në stabilitetin e terrenit përreth, veçanërisht nëse punohet në një zonë ku ka ndodhur shpërbërja e dheut, apo ka probleme me rrëshqitje të tokës. Inxhinieri hidrogjeolog është kyç në sigurimin që ndërtimi i rrugëve të jetë i qëndrueshëm dhe i sigurt, duke menaxhuar dhe vlerësuar ndikimin e ujërave nëntokësore dhe mjedisit përreth. Po ashtu, prezenca e këtij inxhinieri është e nevojshme sepse kur kryhen punime të kësaj natyre në një zonë të banuar, sikurse është objekti i prokurimit object ankimi, ekziston mundësia që infrastruktura ekzistuese (si shpërndarës uji, kabllot elektrike, linjat e telefonisë, etj.) mund të dëmtohet gjatë punimeve të ndërtimit të rrugës. Po ashtu, prezenca e inxhinierit me këtë profil është e nevojshme që të analizojë mundësitë e përmblyes dhe të

sugjerojë sisteme të përshtatshme të drenazhimit që do të mbrojnë banesat dhe infrastrukturën e zonës nga dëmet e mundshme, duke pasur parasysh faktin se punimet po kryhen në një zonë të banuar dhe uji mund të grumbullohet dhe të shaktojë përmytje lokale në zonën ku kryhen. Sa më sipër Komisioni gjykon se, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesa e autoriteti kontraktor për 1 (një) inxhinier hidrogjeolog, i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoriteti kontraktor më sipër, përcaktuar, është në propocion me objektin dhe natyrën e kësaj procedure prokurimi, në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.5 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, e më konkretisht: *kërkesa për një Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder shtesë si staf mbështetës është e tepruar, joproporcionale dhe në kundërshtim me parimet e prokurimit publik dhe duhet të hiqet.*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5., ka parashikuar si më poshtë:

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë staf mbështetës si më poshtë:

- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder 1 (një)

*Stafi i sipërcituar duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit si dhe duhet të paraqesë dokumentacionin: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.*

**Shënim:** *Për kriterin si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit*

III.4.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.4.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
  - a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
  - b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
  - c) *aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.4.5. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.4.6. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriterë autoriteti kontraktor ka argumentuar: **Argumentim:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

**1 Inxhinier Elektrik:** Kërkohet për realizimin dhe mbikëqyrjen e instalimeve elektrike që lidhen me spostimit të shtyllave elektrike dhe elementë të tjerë elektrikë, duke siguruar funksionalitet dhe përputhshmëri me standardet teknike.

**1 Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder:** Inxhinieri kryesor do të fokusohet në drejtimin teknik, kontrollin dhe verifikimin e saktësisë së të dhënave, si dhe në përgatitjen e dokumentacionit përfundimtar, ndërkohë që kërkesat e përditshme në terren përfshijnë një volum të konsiderueshëm matjesh, vendosje piketash, kontroll të kuotave dhe përditësim të vazhdueshëm të të dhënave në funksion të ecurisë së punimeve. Këto procese kërkojnë prani të vazhdueshme në terren dhe ndërhyrje të shpejtë në disa segmente njëkohësisht, gjë që e bën të pamundur përmbushjen efikase vetëm nga një person. Për këtë arsye, angazhimi i një Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder si staf mbështetës është i domosdoshëm për të siguruar mbulimin e plotë të fronteve të punës, për të garantuar vazhdimësinë operacionale dhe për të shmangur vonesat që mund të ndikojnë në afatet e realizimit të projektit.

III.4.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në

këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij si mbështetës *1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesa e autoriteti kontraktor *1 (një) inxhinier ndërtim, profili Gjeodet/Topograf/Markshajder*, i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni sqaron se, *Inxhinieria Gjeodezike/Topografike është një degë e inxhinierisë që merret me matjen, përpunimin dhe përfaqësimin e saktë të sipërfaqes së tokës dhe elementeve të saj, duke përfshirë përcaktimin e koordinatave, kuotave dhe pozicionimit në hapësirë. Kjo fushë përfshin kryerjen e matjeve në terren, përpunimin e të dhënave gjeodezike dhe sigurimin e bazës së saktë për projektimin dhe zbatimin e veprave inxhinierike. Inxhinierët gjeodet/topograf janë përgjegjës për realizimin e matjeve topografike, piktimin e objekteve sipas projektit, kontrollin e kuotave dhe verifikimin e saktësisë së zbatimit në terren, me qëllim garantimin që punimet të realizohen në përputhje me projektin dhe specififikimet teknike. Ata luajnë një rol kyç në sigurimin e cilësisë, shmangien e devijimeve dhe garantimin e qëndrueshmërisë dhe saktësisë së veprave ndërtimore.* Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor në procesverbalin e argumentimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike, ka arritur të argumetojë nevojën për staf mbështetës të profilit të tillë ( si *Gjeodet/Topograf/Markshajder* pasi ndarja e roleve ndërmjet inxhinierit kryesor (me funksion drejtues, kontrollues dhe verifikues) dhe atij mbështetës (me prezencë të vazhdueshme në terren) është e arsyeshme dhe në përputhje me praktikën e zbatimit të kontratave të punimeve. Kjo nuk përbën dyfishim të panevojshëm, por organizim funksional për të shmangur vonesa dhe për të garantuar cilësinë e matjeve dhe të dhënave.

Në këtë mënyrë, KPP gjykon, se kërkesa për staf mbështetës *1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder*, është proporcionale me objektin e prokurimit dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për realizimin e qëllimit dhe përmbushjen me sukses të kontratës.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes lidhur me këtë pikë nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.7 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar heqjen e kërkesës për punonjes të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1.Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.7 të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

**2.3.7** *Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 58 (pesëdhjetë e tetë) punonjës për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Staf i menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Permbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës përkatëse në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:*

*1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.*

*2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.*

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

III.5.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

*a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*

*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.5.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.5.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.5.5. Në nenin 39 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.5.6. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar:

**Argumentimi:** *Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.*

*Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.*

*Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 58 (pesëdhjetë e tetë) punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 130 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në Vendimin nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.*

*Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.*

*Kërkesa për 58 (pesëdhjetë e tetë) punonjës është e justifikuar nga volumi dhe kompleksiteti i punimeve në një projekt ndërtimi. Ky numër siguron fuqinë e nevojshme punëtores për zhvillimin paralel të proceseve të ndryshme, duke garantuar respektimin e afateve, cilësinë e zbatimit dhe funksionimin efikas të kantierit.*

III.5.7. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlereson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës.

Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimesit i cili pretendon se “Kërkesa për prezencën në listëpagesë për 3 muajt e fundit është jo proporcionale dhe e panevojshme, pasi operatori ekonomik tashmë disponon stafin e duhur për të përmbushur detyrimet kontraktuale” Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik lidhur me vërtetimin e administratës tatimore dhe të listpagesave të punonjësve për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, është një kërkesë e ekzagjeruar në këtë procedurë prokurimi. Komisioni gjykon se operatorët ekonomikë për shkaqe nga më të ndryshmet, janë të detyruar që të bëjnë ndryshime në stafin e tyre çka cdo të thotë që kjo nuk është një e dhënë statike e pandryshueshme në kohë. Ndryshueshmëria e stafit të operatorëve ekonomikë lidhet me praktikën e brendshme të tyre dhe nuk ndikon aspak në tregues të performancës që duhet t'i shërbejë autoritetit kontraktor si garanci në kriteret kualifikuese. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që punonjësit për kryerjen e punës të figurojnë në listpagesat e sigurimeve shoqërore apo vërtetim nga administrata tatimore ku për tre muajt e fundit të specifikohet numri i punonjësve, pasi operatorët ekonomikë në varësi të nevojave të tyre kanë të drejtë të shtojnë apo reduktojnë staf në periudha të caktuara kohore. Komisioni gjykon se e rëndësishme është që operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave të kenë në dispozicion stafin e kërkuar nga autoriteti kontraktor i cili do të përbënte garanci se kontrata që do të lidhet si rezultat i procedurës së prokurimit do të realizohet në kohë dhe me sukses.

Kriteri sa më sipër që punonjësit për kryerjen e punës të figurojnë në listpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave apo vërtetim nga administrata tatimore po për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës dhe është tërësisht i panevojshëm. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente provojnë se disponojnë numrin e kërkuar të punonjësve dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguruar por kurrësi të kushtëzohet operatorët ekonomikë që të vërtetojë një numër të tillë punonjësish për periudhën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si punonjësit të figurojnë në listpagesa për të gjithë periudhën e specifikuar më sipër. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në lidhje me periudhën kohore të kërimit të vërtetimit të numrit të punonjësve dhe listpagesave të tyre pasi sic është argumentuar më lart e rëndësishme është që në momentin e hapjes së ofertave të vërtetohet numri i punonjësve në përmbushje të kapacitetit profesional.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.8 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar: *uljen e numrit të specialistëve dhe stafit mbështetës, duke përshtatur kërkesat në përputhje me natyrën reale të punimeve të projektit, në mënyrë që të mos krijohet një barrierë të panevojshme për konkurrencën.*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.8 të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

*2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listpagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si më poshtë:*

- Teknik Ndërtimi	2 (dy)	Diplomë të shkollës mesme
- Teknik Topograf	2 (dy)	Diplomë të shkollës mesme
- Teknik Hidroteknik	1 (një)	Diplomë të shkollës mesme
- Punonjes Hidraulik	1 (një)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Karpentierë	4 (katër)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Betonues	4 (katër)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Hekurkthyes	3 (tre)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Hidraulik	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Elektracist	1 (një)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Saldator	1 (një)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- Punëtorë asfalti	12 (dymbëdhjetë)	Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale

- Punëtorë të thjeshtë 5 (pesë)

Krahas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

<b>nr.</b>	<b>emër mbiemër i punonjësit</b>	<b>profesioni</b>	<b>institucioni public/privat lëshues i certifikatës/diplomës</b>	<b>nr. i certifikatës/diplomës</b>	<b>nr nipt (në rast se lëshuesi është institucion privat)</b>
1.					
2.					
etj.					

**Shënim:** Disponimi i stafit/punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në dst, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, dëshmi/ çertifikatë kualifikimi ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose të lartë.

III.6.2. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 "Kërkesat për kualifikim" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar shprehimisht thuhet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës."

Neni 39, pika 4 dhe 6, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikon se: "4.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese,

natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.6.3. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specififikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes mbi uljen e numrit të specialistëve të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.8 e më konkretisht; *Kërkesa për dy (2) Teknikë Ndërtimi dhe dy (2) Teknikë Topograf është e panevojshme, pasi këto funksione tashmë mbulohen nga Inxhinieri Ndërtimit dhe Inxhinieri Topograf të stafit drejtues teknik, të cilët kanë kompetencat dhe përgjegjësitë profesionale për mbikëqyrjen e punimeve në terren. Një (1) Teknik Topograf dhe një (1) Teknik Ndërtimi janë mëse të mjaftueshëm për zbatimin praktik të detyrave të përditshme dhe mbështetjen e stafit drejtues teknik. Pra, numri i kërkuar i teknikëve shtesë nuk është i nevojshëm dhe mund të konsiderohet i tepërt në kuadër të procedurës së prokurimit. Kërkesa për një Teknik Hidroteknik është gjithashtu e tepërt, pasi ky funksion mbulohet tashmë nga Inxhinieri Hidroteknik i stafit drejtues teknik të parashikuar në procedurë... kërkesa për 3 specialistë Hidraulikë është gjithashtu e tepërt. Punimet janë të thjeshta dhe përfshijnë kryesisht mbingritje pusetash dhe vendosjen e 14 puseta shiu. Për një volum kaq të vogël punimesh, mjafton një hidraulik . ? Specialistët 4 Karpentiere, 4 Betonues dhe 3 Hekurkthyes janë gjithashtu të tepërt... Kërkesa për 12 (dymbëdhjete) punonjës asfalti është e tepruar. Për natyrën dhe volumet e punimeve të parashikuara në këtë tender kryesisht asfaltim i shtresave rrugore urbane dhe vendosje e trotuareve mjafton 3 (tre) punonjës asfalti*

*për të realizuar punimet në mënyrë efikase dhe në përputhje me afatet e kontratës, referuar objektit dhe volumit të kontratës objekt-prokurimi, sasive dhe karakteristikave të punëve të parashikuara në preventiv, Komisioni gjykon se kjo kërkesë e autoritetit kontraktor nuk është kufizuese. Në rastin konkret, procedura e prokurimit objekt ankimi është ndërtim i rrugëve në të cilën përfshihen punime të natyrës gërmime dheu me eskavator, transport dheu, shtresë stabilizanti, spostim shtylle elektrike, etj punime të cilat referuar sasive respektive të përcaktuara në preventiv, kërkojnë specialistët e kërkuar nga autoriteti kontraktor, me qëllim realizimin në përputhje me specifikimet teknike dhe natyrën e kontratës në fjalë. Ndërsa sa i takon numrit të kërkuar për secilin specialitet të kërkuar në këtë pikë, referuar pretendimeve të ankimesit si dhe argumentimit të bërë nga autoriteti kontraktor në procesverbalin për argumentimin e kriterëve kualifikuese, në të cilin autoriteti kontraktor ka dhënë një argumentim të përgjithshëm, pra ka argumentuar vetëm lidhur me nevojën sa i përket specialitetit dhe nuk ka argumentuar nevojën për numrin e kërkuar për këto specialitete, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin e kualifikimit 2.3.8 lidhur me kërkesën për numrin e specialistëve të kërkuara dhe nëse vlerëson se ky numër i kërkuar është i domosdoshm, në realizimin me sukses të kontratës, të argumentojë teknikisht vendosjen e tyre në përputhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Në të kundërt nëse vlerëson se ky numër i kërkuar nuk është i nevojshëm të modifikojë kërkesën për numrin e specialistëve dhe të përcaktojë një numër të nevojshëm për realizimin me sukses të saj.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik lidhur me këtë pikë qëndron pjesërisht.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.9 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar: *heqjen e dy manovratorëve si dhe uljen e numrit të buldozeristëve*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.9 të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

**2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:**

- 4 (katër) shofere të mjeteve të rënda/kamioni;
- 2 (dy) manovratorë;
- 4 (katër) automakinistë;
- 2 (dy) eskavatoristë;
- 4 (katër) buldozeristë.

**Ofertuesi për stafin e mësipërm duhet të paraqesë:**

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.
- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë emer/mbiemer, profil i punës, numri dhe datën e kontratës

*individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.*

- d) *Punetoret e mesiperm te figurojne ne listepagesa për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.*

***Në rastin kur punonjësit Manovratorë, Ekskavatoristë, Shofer ose buldozerist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).***

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar dhe i renditur i pari pas vleresimit te ofertave, duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar per punetoret e mesiperm.*

III.7.2. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar shprehimisht thuhet se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

Neni 39, pika 4 dhe 6, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“4.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

d) *mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*”.

III.7.3. Në nenin 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore”, pika 1. të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. *Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:*

a) *mjete që lëvizin me forcën e krahut;*

b) *mjete të tërhequra me kafshë;*

c) *mjete me pedal;*

d) *slita;*

e) *ciklomotori;*

f) *motomjete;*

g) *automjete;*

h) *trolejbusë;*

i) *rimorkio;*

j) *makina bujqësore;*

k) *makina teknologjike;*

l) *mjete rrugore të veçanta.*

III.7.4. Në nenin 58 “Makinat teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. *Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nganjë vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.*

2. *Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në:*

a) *makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut;*

b) *makina që zhbllokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji; c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve.*

3. *Makinat teknologjike vetëlëvizëse, sipas karakteristikave që kanë, mund të kenë jo më shumë se tri ndenjëse për personelin e shërbimit, duke përfshirë edhe drejtuesin e tyre.*

4. *Për t'iu përshtatur qarkullimit rrugor, këto makina nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 40 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale, kurse makinat teknologjike vetëlëvizëse me rrota jopneumatike a me zinxhirë nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 15 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale.*

III.7.5. Në nenin 2 “Qëllimi, Objekti i Rregullores dhe Fusha e Veprimit” të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet, Kriteret dhe Programet për Përgatitjen Teoriko-Praktike të Kandidatëve, si dhe Dhënien e Dëshmisë së Aftësisë

*Profesionale për Përdoruesite Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke, si dhe Disiplinimi i Përdorimit të Makinerive të Ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se:*

*Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe rregullat për: 1. përgatitjen teorike dhe praktike të shtetasve që kërkojnë të pajisen me Dëshminë e Aftësisë Profesionale DAP, të përdoruesit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke; 2. vendosjen e rregullave të administrimit, organizimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke nga subjekte ose persona që i kanë në posedim.*

*Në nenin 3 “Përkufizime për efekt të kësaj rregulloreje” të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet, Kriteret dhe Programet për Përgatitjen Teoriko-Praktike të Kandidatëve, si dhe Dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për Përdoruesite Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke, si dhe Disiplinimi i Përdorimit të Makinerive të Ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se:*

*Përkufizime për efekt të kësaj rregulloreje: a) “Dëshmia e Aftësisë Profesionale” (DAP), dokument që provon se personi zotëron njohuri të mjaftueshme teorike dhe praktike mbi përcaktimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga aksidentet në punë dhe njohurive teknike dhe profesionale për përdorimin e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke;*

*Në nenin 7 “Kriteret për Klasifikimin dhe Emërtimin e Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke dhe Lëshimit të Dëshmisë Aftësisë Profesionale (DAP)” të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet, Kriteret dhe Programet për Përgatitjen Teoriko-Praktike të Kandidatëve, si dhe Dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për Përdoruesite Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke, si dhe Disiplinimi i Përdorimit të Makinerive të Ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se:*

*Në kuptimin e kësaj rregulloreje, makineritë e ndërtimit ndahen në dy grupe si:*

- 1. Makineri të rënda të punimeve të ndërtimit që përfshijnë grupin e makinerive që paraqesin vështirësi të larta teknologjike e teknike në përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre.*
- 2. Makineri të tjera ndërtimi që përfshijnë të gjitha llojet e makinerive të ndërtimit e të prodhimit të materialeve të ndërtimit, të cilat nuk përfshihen në grupin e parë.*

*Në nenin 8 “Kriteret për Klasifikimin dhe Emërtimin e Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke dhe Lëshimit të Dëshmisë Aftësisë Profesionale (DAP)” të Urdhërit nr. 200, datë 16.05.2019 “Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet, Kriteret dhe Programet për Përgatitjen Teoriko-Praktike të Kandidatëve, si dhe Dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për Përdoruesite Makinerive të Rënda për Punime Ndërtimi dhe Toke, si dhe Disiplinimi i Përdorimit të Makinerive të Ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se:*

- 1. Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësisë Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:*

a)- eskavator gjermimi e ngarkimi dherash:- të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST;

b)- buldozer gjermimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj. manovratorëve u jepet dëshmi për BULDOZERIST.

c)- Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.

III.7.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.9 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ka kërkuar pjesë të stafit disponimin edhe të dy manovratorëve. Urdhri nr. 200, datë 16.05.2019 “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimin e përdorimit të makinerive të ndërtimit””, konkretisht, neni 8, Kreu III i këtij akti, përcakton klasifikimin dhe emërtimin e makinerive të rënda, si dhe mënyrën e pajisjes me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), duke identifikuar qartë profilet profesionale të certifikueshme, e konkretisht: Eskavatorist, për makineritë e gjermimit dhe ngarkimit të dherave; Buldozerist, për makineritë e shtyrjes, nivelimit dhe ngjeshjes së dherave; Automakinist, për automjetet për përdorim të veçantë mbi bazë automjeti. Referuar këtij akti nënligjor rezulton se terminologjia “manovrator” e përdorur nga autoriteti kontraktor në kriterin e kualifikimit 2.3.9 nuk është një kategori ligjore e certifikuar, dhe si e tillë nuk lidhet me një dokument zyrtar provues të standardizuar.

Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor për dy manovratorëve nuk është i qartë dhe i verifikueshëm, si dhe nuk është i harmonizuar me kuadrin ligjor sektorial që rregullon certifikimin e drejtuesve të mjeteve të rënda. Komisioni vlerëson se një mënyrë e tillë e hartimit të kriterit të kualifikimit krijon hapësirë për interpretim subjektiv dhe trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me nenin 2 të LPP. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt - prokurimi, por

në çdo rast këto specifikime teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike joproporcionale dhe të pajustificuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar.

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin e kualifikimit 2.3.9 lidhur me kërkesën për dy manovratorë dhe nëse vlerëson se këta dy manovratorë janë të domosdoshme, në realizimin me sukses të kontratës, referuar kjo edhe numrit të makinerive të rënda të kërkuara, të modifikojë kriterin e kualifikimit duke kërkuar personel të certifikuar sipas profileve të përcaktuara në Urdhrin nr. 200, datë 16.05.2019), duke justifikuar dhe argumentuar teknikisht vendosjen e tyre. Në të kundërt nëse vlerëson se nuk janë të nevojshëm të modifikojë kriterin duke e hequr si kërkesë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për uljen e numrit të buldozieristëve, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, Komisioni gjykon se, kriteri lidhur me disponimin e 4 buldozieristëve është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi nuk është në përputhje me volumet e kontratës që prokurohet dhe si rrjedhojë kufizues ndaj konkurrencës. Referuar edhe proces-verbalit të argumentimit të kriterëve të vecanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka dështuar në argumentimin teknik (analitik dhe narrativ) të numrit të caktuar të profilit të sipërcituar (buldozieristëve). Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kërkesën për disponimin e katër buldozieristëve, në proporcion me natyrën dhe volumet e kontratës objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III. 8.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për kriterin 2.3.10 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, e konkretisht : *1. Të hiqen nga lista mjetet, të cilat nuk janë të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës sic është Dumper me kapacitet mbajtës mbi 20 ton me targa, Rrul asfalti gomë gomë 4- 8 ton Rrul ngjeshes gomë-hekur me dhembe (gunga) kapaciteti mbi 15 ton Autobetonierë kantieri vetëngarkuese 2.5 - 3.5 m<sup>3</sup> me targa Makineri teknologjike thithëse për pastrimin e mbetjeve të ujrave të ndotura/të zeza (mbingritje pusetash). 2. Të ulet numri i mjeteve të tepruara, duke e përshtatur atë me natyrën reale të punimeve dhe volumet që do të kryhen, sic janë kamioncinat,autobitumatricet,rulat etj. 3. Të hiqet kërkesa për pajisjen me targa të mjeteve teknologjike (dumper,minidumer,fadroma minifadrome,pirun,eskavatori,greideri etj.), duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe faktin që këto mjete përdoren vetëm brenda kantierit dhe nuk qarkullojnë në rrugë publike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.8.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, seksionin II “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.10, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Lloji i makinerive</b>	<b>Sasia</b>	<b>Pronësia</b>
1	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
3	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 Ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 1.2-3.5 Ton	3 copë	Në pronësi ose me qera
5	Dumper me kapacitet mbajtës mbi 20 ton me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Minidumper me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Pirun teleskopik me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Vinç me kosh me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera
9	Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash	2 copë	Në pronësi ose me qera
10	Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti	2 copë	Në pronësi ose me qera
11	Rrul asfalti gomë – gomë 4- 8 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
12	Rul ngjeshes gomë-hekur me dhembe (gunga) kapaciteti mbi 15 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
13	Fadrome me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera
14	Minifadrome me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera
15	Eskavator me zinxhir + çekiç (matrapik)	1 copë	Në pronësi ose me qera
16	Eskavator me targa	1 copë	Në pronësi ose me qera
17	Minieskavator	2 copë	Në pronësi ose me qera
18	Grejder me targa	2 copë	Në pronësi ose me qera
19	Asfaltoshtuese	2 copë	Në pronësi ose me qera
20	Autobitumatriçe me certifikatë për transport lëndë të rrezikshme	3 copë	Në pronësi ose me qera
21	Autobot Uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
22	Autobetonierë	2 copë	Në pronësi ose me qera
23	Autobetonierë kantieri vetëngarkuese 2.5 - 3.5 m <sup>3</sup> me targa	2 copë	Në pronësi ose me qira
24	Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
25	Makineri (spërkatës) për vijezim rruge me bojë bikomponente	1 copë	Në pronësi ose me qera
26	Betonierë kantieri 0.5m <sup>3</sup>	2 copë	Në pronësi ose me qera

27	Betoforma (armaturë, kallëp) dërrase	500 m <sup>2</sup>	Në pronësi ose me qera
28	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
29	Vibrator betoni	4 copë	Në pronësi ose me qera
30	Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator)	1 copë	Në pronësi ose me qera
31	Gjenerator ≥ 3.5kë	1 copë	Në pronësi ose me qera
32	Pompe uji per pastrim	2 copë	Në pronësi ose me qera
33	Makineri teknologjike thithëse për pastrimin e mbetjeve të ujrave të ndotura/të zeza (mbingritje pusetash)	1 copë	Në pronësi ose me qera
34	Makineri për skarifikim shtresash asfalti ekzistues/ frezë asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qera
35	GPS/Total Station	1 copë	Në pronësi ose me qera

**Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:**

**a)** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikatë për transport mallrash.

**b)** Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.

**c)** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

**d)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku për mjetet me targa të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

**e)** Për autobitumatriçe të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshme.

**f)** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklarara sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.

**g)** Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

III.8.2. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 "Kërkesat për kualifikim" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar shprehimisht thuhet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

Neni 39, pika 4 dhe 6, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se: “4.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.8.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes *Kërkesa për një Dumper me kapacitet mbajtës mbi 20 ton me targa rezulton e pajustificuar, pasi nga preventivi evidentohet se transporti është parashikuar deri në 5 km dhe Punimet janë në rrugë urbane/lokale dhe nuk kërkojnë përdorimin e mjeteve të kësaj kategorie të rëndë. Gjithashtu punimet e parashikuara mund të realizohen në mënyrë efikase me mjete më të lehta dhe më fleksibël, të cilat janë tashmë të përfshira në listën e mjeteve sic është minidamperi dhe kamioncinat, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përkatësisht grafikut dhe preventivit të punimeve, Komisioni konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor,*

në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta për kualifikim për procedurën objekt ankimi, nuk është argumentuar se përse ky mjet është i domosdoshëm në realizimin me sukses të kontratës. Komisioni vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor për një dumper me kapacitet mbi 20 ton rezulton e pajustificuar dhe jo proporcionale me natyrën dhe volumin e punimeve. Nga analiza e dokumentacionit teknik konstatohet se transporti është parashikuar në distanca të shkurtra (deri në 5 km), punimet zhvillohen në rrugë urbane/lokale, ku kërkohet fleksibilitet dhe manovrueshmëri më e lartë. Në këto kushte, kërkesa për një mjet të rëndë mbi 20 ton nuk lidhet drejtpërdrejt me nevojat reale të kontratës dhe krijon kufizim të panevojshëm të konkurrencës. Për më tepër realizimi i punimeve mund të kryhet në mënyrë efikase me mjete më të lehta, të cilat janë të parashikuara (*sic eshte minidamperi dhe kamioncinat*). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt - prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike joproporcionale dhe të pajustificuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kërkesën lidhur me këtë makineri duke e hequr nga lista e makinerive të kërkuara.

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimes për pikën 2.3.10 të kriterëve të kualifikimit, e më konkretisht: *Kërkesa për 3 (tre) autobitumatriçe rezulton e pajustificuar dhe jo proporcionale me natyrën e kontratës; kërkesa për dy Autobetonierë kantieri vetëngarkuese 2.5 - 3.5 m3 është e tepërt dhe kufizuese; Kërkesa për një Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri 1.23.5 ton është gjithashtu e kufizuar dhe e panevojshme në raport me natyrën e kontratës; Kërkesa për dy (2) rrula asfalti gomë gomë 4-8 ton është totalisht e panevojshme për objektin që prokurohet; Kërkesa për një rul ngjeshës gomë hekur me dhembe (gunga) kapaciteti mbi 15 ton është gjithashtu e tepërt dhe e panevojshme për objektin që prokurohet.* KPP konstaton se në procesverbalin për argumentimin e kriterëve të kualifikimit autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar teknikisht numrin e mjeteve dhe kapacitetin e kërkuar në këtë pikë, por thjesht ka bërë një justifikim të përgjithshëm për mjetet e sipërpërmendura. Sa më sipër KPP vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin e kualifikimit 2.3.10 lidhur me kërkesën për numrin e mjeteve të kërkuara dhe nëse vlerëson se ky numër i kërkuar është i domosdoshëm, në realizimin me sukses të kontratës, të argumentojë teknikisht vendosjen e tyre. Në të kundërt nëse vlerëson se nuk janë të nevojshëm të modifikojë kërkesën për numrin e mjeteve dhe kapacitetin mbajtës të mjeteve dhe të përcaktojë një numër të nevojshëm për mjetet për realizimin me sukses të saj.

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes sa i përket heqjes së kërkesës për disponimin e një makinerie teknologjike thithëse për pastrimin e mbetjeve të ujërave të ndotura/të zeza, rezulton e pajustificuar dhe jo proporcionale me objektin e kontratës, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përkatësisht grafikut dhe preventivit të punimeve, Komisioni konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor, në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta për kualifikim për procedurën objekt ankimi, nuk është argumentuar teknikisht se

përse ky mjet është i domosdoshëm në realizimin me sukses të kontratës, por është bërë një justifikim i përgjithshëm. Po ashtu, nga ana e autoritetit kontraktor në shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk është argumentuar se heqja e mjetit të mësipërm ndikon në cilësinë e realizimit me sukses të punimeve dhe njëkohësisht të kontratës objekt prokurimi. Për më tepër, duke iu referuar zërave të punimeve në preventiv nuk ka zëra që lidhen me përdorimin e kësaj makinerie. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me artikujt objekt - prokurimi, por në çdo rast këto specifikime teknike duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet, si dhe duhet të jenë të justifikuara teknikisht, bazuar në fakte dhe prova konkrete, pasi vendosja e specifikimeve teknike joproporcionale dhe të pajustificuara, shkakton kufizime dhe përjashtime tërësisht të panevojshme nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kërkesën lidhur me këtë makineri dhe nëse vlerëson se vendosja e saj është e domosdoshme, si dhe ndikon në realizimin me sukses të kontratës të justifikojë dhe argumentojë teknikisht vendosjen e saj.

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se: *Gjithashtu kërkesa që Dumper, Minidumper, Pirun teleskopik fadroma, minifadrome, eskavatori, greideri, Autobetonierë kantieri etj. të jene të pajisura me targa është juridikisht e gabuar*, referuar Nenit 58, i Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se “*Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë...*”. Fakti që këto mjete janë me goma jo domosdoshmërisht përcakton dhe detyrimin që të pajisen me targa. Ndërkohë në nenin 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 4 përcaktohet se: *për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit, ndërsa në rastin kur lëvizin vetëm në kantier atëherë nuk kanë detyrim që të pajisen me targa*. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se përcaktimi i autoritetit kontraktor për pajisjen me targa të mjeteve teknologjike, të cilat përdoren brenda kantierit dhe mund të transportohen me mjete të tjera pa qenë e nevojshme të qarkullojë në rrugë publike, është një përcaktim i cili bie ndesh me bazën ligjore të sipërpermendur. Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri duke hequr kërkesën për pajisjen me targa për këtë kategori mjeteve teknologjike.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruktion” SHPK, për modifikimin e kriterit 2.3.11 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar: *Kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO 3834-2:2021 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim) është e pajustificuar, joproporcionale dhe në kundërshtim me natyrën e objektit të prokurimit. Kërkojmë heqjen e këtij kriteri nga DST, pasi bie ndesh me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.9.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.11., ka parashikuar si më poshtë:

*2.3.11 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:*

*\* ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)*

*\* ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)*

*\* ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë)*

*\* ISO 3834-2:2021 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim)*

*Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar.*

*Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë ISO duhet plotësuar nga operatorët ekonomik, sipas natyrës së punëve që marrin përsipër.*

***Shënim: Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.***

III.9.2. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar: **“Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i publikuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.**

***ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)*** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë

në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

Në ndërtimin e rrugëve, ku cilësia e shtresave (bazë, nënbazë, asfalt) është kritike për jetëgjatësinë e investimit, ISO 9001 minimizon rrezikun e defekteve dhe punimeve jashtë standardit.

**ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Në një zonë si Valiasi (zonë e banuar), kjo është veçanërisht e rëndësishme për të minimizuar ndikimin negativ tek komuniteti dhe mjedisi përreth.

**ISO 45001:2018 /45001-2023, (Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë)** është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 /45001-2023, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Punimet e ndërtimit të rrugëve përfshijnë rreziqe të larta (makineri të rënda, trafik, punë në terren). Kjo certifikatë siguron që: të identifikohen dhe menaxhohen rreziqet në kantier, mbrohen punonjësit dhe palët e treta, reduktohen aksidentet dhe incidentet në punë.

**ISO 3834-2:2021 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim)**, kërkohet për të garantuar që tabelat rrugore, barrierat dhe elementët metalikë të rrugës janë të salduar sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë, duke siguruar qëndrueshmëri strukturore dhe siguri për përdoruesit e rrugës.

III.9.3. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në

*procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

*Neni 3, Parime të përgjithshme parashikon: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

*III.9.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, parashikon: 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

*III.9.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.*

*III.9.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për heqjen e kërkeses për Certifikatën SSH/ENISO 3834-2:2021 e përditësuar, duke parashtruar argumenta se kjo kërkesë është e tepër dhe e pargumentuar teknikisht, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera se Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin ndër të tjera edhe Certifikatën SSH/ENISO 3834-2:2021 e përditësuar. Referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, procesverbalit të hartimit të kriterëve të kualifikimit, KPP konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht mbi kërkesën*

për këtë certifikatë por thjesht ka justifikuar vendosjen e tyre bazuar në LPP. Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të paraqesin edhe këtë certifikatë, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesa e autoriteti kontraktor për Certifikatën SSH/ENISO 3834-2:2021 nuk i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Certifikata SSH/ENISO 3834-2:2021 shtë një standard evropian që specifikon kërkesat për cilësinë e saldimit të materialeve metalike, duke siguruar udhëzime për menaxhimin dhe kontrollin e operacioneve të saldimit, me qëllim që të sigurohet cilësi e lartë e punimeve të salduara. Ndërkohë referuar zërave të preventivit të procedurës së prokurimit object ankimi , të cilat i përkasin ndërtimit të rrugëve nuk përfshihen pjesë metalike strukturore (si ura, mbikalime, ose mbështetje të tjera metalike), për të cilat do të mund të justifikohet një certifikatë ë tillë, certifikatë e cila është e nevojshme për të siguruar lidhje të qëndrueshme dhe të sigurt. Në rastin konkret natyra e punëve është punime asfaltit, punimeshtresave të tokës, mbushje cakelli etj, ku saldimit nuk është i përfshirë. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për Certifikata SSH/ENISO 3834-2:2021 duhet të hiqet, për sa kohë nuk është në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Almo Konstruktion” SHPK, për modifikimin e kriterit 2.3.12 të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar... *Në përfundim, kërkesa për licencë të lëshuar nga QKL, Kodi III.2.B Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta 17 03 02 ;20 02 02 20 03 06 është e pambështetur në objektin e kontratës, nuk ka lidhje me preventivin apo punimet që do të kryhen dhe bie ndesh me natyrën e kontratës. Për sa më sipër, Kërkojmë heqjen e kodeve 17 03 02; 20 02 02 dhe 20 03 06 nga kriteret e kualifikimit.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.10.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.12., ka parashikuar si më poshtë:

**2.3.12 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga QKB me Kodin III.2.B - Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta, së bashku me aktin e miratimit dhe kodet 17 05 04, 17 09**

04,17 03 02, 20 02 02, 20 03 06, në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

III.10.2.Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Ne Ligjin nr. 57 /2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” neni 68, pika 2 dhe 3 parashikohet se: “2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. 3. Licenca për veprimtari të parashikuara në pikën 2 të këtij neni lëshohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore nga “Qendra Kombëtare e Biznesit”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i licencuar me Kodin III.2.B është e nevojshme sepse gjatë ndërtimit të rrugës krijohen mbetje ndërtimore që duhet të menaxhohen në mënyrë ligjore dhe të kontrolluar.

Kodet e kërkuara lidhen specifikisht me zërat e punimeve, si punime gërmimi, prishje, pastrimi i pusetave dhe mbingritjen e tyre, zëra të cilat shkaktojnë mbetje. Kjo garanton që operatori ekonomik mund të grumbullojë dhe transportojë ligjërisht mbetjet e ngurta të rrugës, duke përfshirë metalet e tabelave, betonin, tullat dhe mbeturinat e tjera të kantierit, duke siguruar siguri mjedisore dhe respektim të rregullave ligjore.

*Kjo licencë garanton që operatori: respekton legjislacionin mjedisor; transporton dhe depoziton mbetjet në mënyrë të rregullt; shmang ndotjen dhe problemet për komunitetin dhe siguron organizim e siguri më të mirë në kantier.*

III.10.3. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3, Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.10.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.10.5. Në seksionin “Kategoria III.2. “ Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se: “Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

III.10.6. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht:

*“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”.*

*Ky ligj përcakton:*

*a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;*

*b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”*

III.7.7. Në shtojcën 1, pika 17 dhe 20 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 402, Datë 30.06.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, përcaktohet: “17 Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshi dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara)” dhe 20 Mbetjet urbane (mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale të ngjashme) përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas

### **17 MBETJE NGA NDËRTIMET DHE PRISHJET (PËRFSHI DHERA TË GËRMUARA NGA ZONA TË KONTAMINUARA)**

*17 01 Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika*

*17 01 01 Beton*

*17 01 02 Tulla*

*17 01 03 Tjegulla dhe qeramika*

*17 01 06 \* Përzierje ose fraksione të ndara betoni, tullash, tjegulla dhe qeramikës që përmbajnë substanca të rrezikshme*

*17 01 07 Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06*

*17 02 Dru, qelqe dhe plastika*

*17 02 01 Dru*

*17 02 02 Qelqe*

*17 02 03 Plastikë*

*17 02 04 \* Dru, qelq dhe plastika që përmbajnë substancë të rrezikshme*

*17 03 Përzierje bituminoze, bitumi dhe produkte të tjera të ziftit*

*17 03 01 \* Përzierje bituminoze që përmbajnë zift qymyri*

*18*

*17 03 02 Përzierje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01*

*17 03 03 \* Zift qymyri dhe katrane*

*17 04 Metale (përfshi dhe aliazhet e metaleve)*

*17 04 01 Bakër, bronz, tunxh*

*17 04 02 Alumin*

*17 04 03 Alumb*

*17 04 04 Zink*

*17 04 05 Hekur dhe çelik*

*17 04 06 Kallaj*

*17 04 07 Metale të përziëra*

17 04 09 \* Mbetje metalore të kontaminuara me substanca të rrezikshme  
 17 04 10 \* Kabllo që përmbajnë naftë, bitum apo substanca të tjera të rrezikshme  
 17 04 11 Kabllo të tjera nga ato të përmendura në 17 04 10  
 17 05 Dhera (duke përfshirë dhera të gërmuara nga toka të kontaminuara, gurë dhe balta të tjera)  
 17 05 03 \* Dhera dhe gurë që përmbajnë substancë të rrezikshme  
 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03  
 17 05 05 \* Balta që përmbajnë lëndë të rrezikshme  
 17 05 06 Balta, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 05  
 17 05 07 \* Çakëll që përmban substanca të rrezikshme  
 17 05 08 Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07  
 17 06 Materiale izoluese dhe materiale ndërtimi me azbest  
 17 06 01 \* Material izolimi që përmban azbest  
 17 06 03 \* Material izolimi që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme  
 17 06 04 Materiale izolimi të tjera nga ato të përmendura në 17 06 01 dhe 17 06 03  
 17 06 05 \* Materiale ndërtimi që përmbajnë asbest  
 17 08 Materiale ndërtimi me gips  
 17 08 01 \* Materiale ndërtimi me gips që janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme  
 17 08 02 Materiale ndërtimi me gips, të tjera nga ato të përmendura në 17 08 01  
 17 09 Mbetje të tjera ndërtimi dhe të prishjeve  
 17 09 01 \* Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë merkur  
 17 09 02 \* Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë PCB  
 17 09 03 \* Mbetje nga ndërtimi dhe të prishjeve, duke përfshirë mbetjet e përziera që përmbajnë substanca të rrezikshme  
 17 09 04 Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09

**20 MBETJET URBANE (MBETJET SHTËPIAKE DHE TREGTARE, MBETJE INDUSTRIALE E INSTITUCIONALE TË NGJASHME) PËRFSHIRË FRAKSIONET E MBLEDHURA VEÇMAS**

20 01 Fraksionet e ndara (përveç 15 01)  
 20 01 01 Letër dhe karton  
 20 01 02 Qelq  
 20 01 08 Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat  
 20 01 10 Veshjet  
 20 01 11 Tekstilet  
 20 01 13 \* Tretësit  
 20 01 14 \* Acidet  
 20 01 15 \* Bazat  
 20 01 17 \* Fotokimikatet  
 20 01 19 \* Pesticidet  
 20 01 21 \* Mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur  
 20 01 23 \* Pajisje skarco që përmbajnë klorofluorokarbone  
 20 01 25 Vajra dhe dhjamëra ushqimore

20 01 26 \* Vajra dhe dhjamëra, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 25  
 20 01 27 \* Bojëra, ngjyra, ngjitës etj., që përmbajnë substanca të rrezikshme  
 20 01 28 Bojëra, ngjyra, ngjitës etj., të tjera nga ato të përmendura në 20 01 27  
 20 01 29 \* Detergjent që përmbajnë substanca të rrezikshme  
 20 01 30 Detergjent të tjerë nga ato të përmendur në 20 01 29  
 20 01 31 \* Medikamente citotoksike dhe citostatike  
 20 01 32 Medikamente të tjera nga ato të përmendura në 20 01 31  
 20 01 33 \* Bateritë dhe akumulatorët të përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe  
 bateritë e  
 akumulatorët e pandarë  
 20 01 34 Bateritë dhe akumulatorët e tjerë nga ato të përmendur në 20 01 33  
 20 01 35 \* Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20  
 01 21 dhe 20 01  
 23 që përmbajnë komponentë të rrezikshëm  
 20 01 36 Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20  
 01 21, 20 01 23  
 dhe 20 01 35  
 20 01 37 \* Mbetje druri që përmbajnë substanca të rrezikshme  
 20 01 38 Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37  
 20 01 39 Plastikët  
 20 01 40 Metalet  
 20 01 41 Mbetjet nga pastrimi i oxhaqeve  
 20 01 99 Fraksione të tjera të paspecifikuara  
 20 02 Mbetjet e kopshteve dhe parqeve (përfshirë mbetjet e varrezave)  
 20 02 01 Mbetje të biodegradueshme  
**20 02 02 Dhera dhe gurë**  
 20 02 03 Mbetje të tjera të pabiodegradueshme  
 20 03 Mbetje të tjera urbane  
 20 03 01 Mbetjet e përziera urbane  
 20 03 02 Mbetje nga tregjet  
 20 03 03 Mbetje nga pastrimi i rrugëve  
 20 03 04 Llumra nga gropat septike  
**20 03 06 Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza**  
 20 03 07 Mbetjet të vëllimshme  
 20 03 99 Mbetjet urbane të paspecifikuara 02 dhe 17 09 03 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03.

III.10.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve

të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.10.9. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe grumbullimi transporti i mbetjeve të ngurta (inerte dhe dherave) mbetje këto të cilat do të dalin kryesisht si rezultat i kryerjes së punimeve për realizimin e kontratës, gjatë kryerjes së veprimtarisë. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se referuar dokumentit “*Preventivi i Punimeve*”, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashikuar kryerjen e punimeve si, *gërmime dhe me eskavator dhe transport dheu*. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081 datë 23.02.2009 “*Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*”, parashikohet se “*Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.*” Sa më sipër, KPP gjykon se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventiviti, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë si (largimi i dherave dhe gërmime me eskavator ku si rrjedhojë e kryerjes së këtyre punimeve parashikohet se një pjesë e këtyre mbetjeve të ngurta të tipit dheu, e cila do të pasjell ndotje të mjedisit si dhe domosdoshmërisht do të kërkojnë trajtimin/largimin e tyre), sipas volumeve të përcaktuara në preventive, si edhe më pas transporti i këtyre mbetjeve. Sa më sipër, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për licencim me Licencë Kodi III.2.B “*Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta,*” është në përputhje me natyrën dhe volumin e preventivitit object kontrate. Pra operatori ekonomik fitues i kontratës duhet të kryejë edhe transportin e këtyre dherave, të cilat do të gjenerohen si pasojë e kryerjes së punimeve, ku referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara.

Lidhur me pretendimet e ankimesit për heqjen e kodeve 17 03 02, 20 02 02 dhe 20 03 06, KPP konstaton se, referuar zërave të preventivitit për të cilat do të kryhen punimet për “*Ndërtim rrugët Blloku Valias, Grupi 1*”, referuar kuadrit ligjor sektorial e konkretisht, VKM Nr. 402, Datë 30.06.2021 “*Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve*”, në të cilin përcaktohet Kodi **17 03 02 Përzierje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01, Kodi 20 02 02 Dhera dhe gurë, ndërsa Kodi 20 03 06 Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza**, kërkesa e autoritetit kontraktor nuk është në propocion me objektin e kontratës është e ekzagjeruar dhe kufizon pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë, të cilat në rastin konkret edhe nëse i referohemi preventivitit të punimeve në asnjë zë të tij nuk parashikohet kryerja e punimeve në lidhje me aktivitetet të cilat përfshinë kryerjen e veprimtarisë si (largimi i dherave dhe gërmime me eskavator), në përputhje me veprimtarin e Licencë Kodi III.2.B “*Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta,*” ndaj dhe është një kërkesë joproporcionale dhe përbën shkak për skualifikim të padrejtë të operatorëve ekonomikë në fazën e vlersimit të ofertave. Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit, duke hequr kërkesën për paraqitjen e aktmiratimit me kodet 17 03 02, 20 02 02 dhe 20 03 06, pasi është një kërkesë që nuk është në përpjesëtim dhe aspak e lidhur me objektin e kontratës.

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.11. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Almo Konstruksion” SHPK për modifikimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.13. të dokumenteve të tenderit për të cilin pretendon: “Kërkesa e AK-së për një laborator të akredituar në fazën e ofertimit për testimet e materialeve është e pa bazë, abuzive dhe e tejkalon nevojat reale të kontratës, pasi çdo testim dhe certifikim i materialeve do të bëhet dhe do të kontrollohet nga mbikqyrësi teknik gjatë zbatimit të kontratës..”, KPP vëren se,

III.11.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, 2.3 Kapaciteti teknik, pikat 2.3.13. autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

**2.3.13** *Operatori Ekonomik të ketë laborator testimi ose kontratë noteriale me një laborator testimi ku laboratori të ketë të akredituara këto teste BS EN 12390-3:2019, BS EN 12390-7:2019, BS EN 480-4:2005, BS EN 12504-2:2021, ASTM C1260:2023 ose BS EN 812-123.*

III.11.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

**Argumentim:** *Kërkesat janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

*Kjo kërkesë është thelbësore për të siguruar kontroll të vazhdueshëm dhe të besueshëm të cilësisë së materialeve ndërtimore, veçanërisht betonit dhe përbërësve të tij.*

*Përmes këtyre testeve verifikohet rezistenca në shtypje e betonit, cilësia dhe integriteti i strukturës së tij, qëndrueshmëria ndaj reaksioneve kimike dhe deformimeve në kohë, si dhe performanca e aditivëve që përdoren në përzierje. Kryerja e këtyre analizave nga një laborator i akredituar garanton që rezultatet janë të sakta, të verifikueshme dhe në përputhje me standardet teknike në fuqi.*

*Në këtë mënyrë, sigurohet që materialet e përdorura në ndërtimin e rrugëve plotësojnë kërkesat e projektit dhe standardet e sigurisë, duke minimizuar rrezikun e defekteve, dëmtimeve të parakohshme dhe kostove shtesë gjatë shfrytëzimit të veprës. Gjithashtu, kjo rrit*

transparencën dhe besueshmërinë në procesin e zbatimit të punimeve, duke garantuar cilësi dhe jetëgjatësi më të lartë të infrastrukturës.

Agregatet që do të përdoren për prodhimin e betonit ose asfaltit duhet të testohen për potencialin e tyre reagues në prezencë të aklakeve dhe duhet të jenë brenda limiteve të përcaktuara në standartin e agregateve në beton 1260 duke testuar pre reaktivitetin alkali silaca sipas standartit BE EN 812-123. Gjithashtu betoni nuk duhet të ketë segregime të cilat gjatë hedhjes në vepër duhet të testohen për Bleeding sipas BE EN 480-4:2005.

III.11.3. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3, Parime të përgjithshme 1. *Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.11.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.11.5. Neni 7 i Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, parashikon se:

*“1. Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve/grupi i mbikëqyrësve caktohet nga zhvilluesi.*

*2. Në rastet kur autoritetet publike investojnë dhe realizojnë një zhvillim në një zonë të caktuar, mbikëqyrësi i punimeve/grupi i mbikëqyrësve përzgjidhet nga autoriteti publik në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.”*

Ndërsa VKM Nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, në Nenin 9, parashikon se: *“1. Mbikëqyrësi i punimeve miraton materialet e ardhura në kantier përpara se të vendosen në objekt, nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, standardet e cilësisë së materialeve, si dhe makineritë e pajisjet e siguruara nga zbatuesi i punimeve, të nevojshme në procesin e ndërtimit. Materialet, të cilat nuk marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, zëvendësohen me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, të cilat duhet të marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve për t’u përdorur në procesin e ndërtimit.*

*2. Mbikëqyrësi i punimeve kryen vëzhgimin dhe korrigjimin e detajeve të elementeve të parapërgatitura (parafabrikat), në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, si dhe standardet e cilësisë së materialeve, të cilat do të përdoren në procesin e ndërtimit.*

*3. Mbikëqyrësi i punimeve duhet të dokumentojë me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, argumentimin e shmangieve të palejuara, referuar standardeve shqiptare ose në mungesë të tyre standardeve evropiane”.*

III.11.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.11.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes mbi disponueshmërinë e laborator testimi ose kontratë noteriale me një laborator testimi ku laboratorit të ketë të akredituara këto teste BS EN 12390-3:2019, BS EN 12390-7:2019, BS EN 480-4:2005, BS EN 12504-2:2021, ASTM C1260:2023 ose BS EN 812-123.. është e panevojshme dhe si e tillë duhet të hiqet nga kriteret e kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera se *Operatori Ekonomik të ketë laborator testimi ose kontratë noteriale me një laborator testimi ku laboratorit të ketë të akredituara këto teste BS EN 12390-3:2019, BS EN 12390-7:2019, BS EN 480-4:2005, BS EN 12504-2:2021, ASTM C1260:2023 ose BS EN 812-123..* Komisioni gjykon se një kërkesë e tillë jo në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme. Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit

administrativ, procesverbalit të hartimit të kriterëve të kualifikimit, ku thjesht ka justifikuar vendosjen e duke referuar vtëm nenin 77 të LPP, pa arguemntuar teknikisht dipsonimin ose kontratën e lidhur me një laborator testim materialesh. Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik të ketë laborator testimi/kontratënoteriale, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, referuar llojit të kontratës, volumit dhe përmasave të saj si dhe zërave të preventivit kërkesa e autoriteti kontraktor si më sipër cituar, nuk i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, pasi për testimin e performancës së produkteve të ndërtimit, për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e cilësisë së materialeve ndërtimore dhe për sigurimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike, për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, i cili ka detyra dhe përgjegjësi të parashikuara në kuadrin ligjor sektorial, ku ndër to është edhe miratimi i materialeve të ardhura në kantier përpara se të vendosen në objekt, nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, standardet e cilësisë së materialeve, si dhe makineritë e pajisjet e siguruara nga zbatuesi i punimeve, të nevojshme në procesin e ndërtimit. Materialet, të cilat nuk marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, zëvendësohen me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, pra materialet duhet të marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve për t'u përdorur në procesin e ndërtimit. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin laboratorit të testimit/kontratënoteriale duhet të hiqet, për sa kohë referuar bazës ligjore sektoriale në ndërtim, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e cilësisë së materialeve ndërtimore dhe për sigurimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike realizohet nga mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, pa qenë nevoja e profilizimeve si më sipër. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendosi:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. Nr. REF-80711-04-01-2026, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Valias, Grupi 1” me fond limit 172,262,930.82 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 17.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
  2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të KPP-së të shprehura në këtë vendim dhe të publikojë shtojcën respektive.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

